



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

MIRATOI

Ergys Verdho

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

# TERMA REFERENCE

Për mbikëqyrjen e punimeve të objektit ;  
“ Rikonstruksioni i Urave të Kaludhit, Dragotit dhe Leklit; Ndërtimi i Urës së  
Zëmplakut”

## HARTOI:

**Altin Sula** *Specialist, Sektori i H P.B. pranë Drejtorisë së P.S.O.-së*

**Dorina Meksi** *Specialiste, Sektori i H P.B. pranë Drejtorisë së P.S.O.-së*

**Donika Shehu** *Sektori i Preventivit pranë Drejtorisë së P.S.O.-së*

## PRANOI:

**Simon Prendi** *P/sekt, Sektori i H P.B. pranë Drejtorisë së P.S.O.-së*

## APROVOI:

**Erald Elezi** *Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Operacioneve*

TIRANE 2019

## Hyrje

Autoriteti Rrugor Shqiptar me fondet e buxhetit të vitit 2019 kërkon që të financojë ndërtimin e objektit “**Rikonstruksioni i Urave të Kaludhit, Dragotit dhe Leklit; Ndërtimi i Urës së Zëmbllakut**”, me fond limit për zbatimin e punimeve 88 278 687,64 lekë pa tvsh. Për këtë qëllim kërkohet të bëhet mbikëqyrja gjatë fazës së ndërtimit të objektit, mbështetur në këto Terma Reference.

## I - INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Me fondet nga buxheti të shtetit për vitin 2019 dhe 2020 janë parashikuar të kryhen mbikëqyrja e punimeve në objektin “**Rikonstruksioni i Urave të Kaludhit, Dragotit dhe Leklit; Ndërtimi i Urës së Zëmbllakut**” me vlerë për mbikëqyrje punimesh prej: **1 738 185,65 lekë** (pa TVSH), grupi i dytë tarifor sipas vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 354, datë 11.05.2016 “*Përmiratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*”.

**Ura e Dragotit** është një vepër arti e rëndësishme përgjatë aksit rrugor Tepelenë – Përmet dhe njëkohësisht është ura me hapësirë drite më të madhe në Shqipëri. Kjo urë lidh dy anët e kësaj rruge mbi lumin Vjosë. Në vitet 1934 – 1935 kemi projektin përfundimtar nga ing. Confatonier të studios italiane ANSALDO s.a.. Projekti i urës është mbistruktura kapriatë çeliku Tip Hark dhe nënstruktura është beton arme (shpatullat), lidhja e saj me mbi strukturën me çerniera të lëvizshme dhe të palëvizshme. Gjatësia e urës është  $L=110m$  e gjerësia e saj  $7,5m$  (rrugë automobilistike  $4,7m$  e trotuar  $2x1$ ). Lidhur me hartimin e mënyrës së ndërhyrjeve, po rendisim disa nga elementet që kemi marrë në konsideratë: Ura ka një jetëgjatësi prej më shumë se 80 vjet, për rrjedhje materiali ka kaluar ciklin e lodhjes ose duhet të jetë afër tij. Kodet e projektimit të periudhës 1935 – 1937 “të vjetruara” në lidhje me kërkesën e kodeve të sotme. Lidhur me mënyrën e projektimit e zbatimit të punimeve nuk ka ndonjë informacion, veçanërisht për llojin e skemë ngarkesës së projektimit. Mungesa e punimeve të mirëmbajtjes, veçanërisht ato rutinë, mungesa e inspektimit dhe historisë së lëvizjes së ngarkesave të mëdha në urë. Mos plotësimi i kërkesave të lëvizjes së mjeteve në funksion kjo të kategorisë së rrugës, si në plan ashtu edhe në seksionin tërthor. Gjithë defektet e gjetjet e treguara më sipër.

**Ura e Kaludhit** ndodhet në fshatin me të njëjtin emër dhe shtrihet në rrugën Përmet – Çarshovë, mbi lumin e Darsit, i cili derdhet në lumin Vjosa. Ura ekzistuese ka dy hapësira dritë. Hapësirat e urave janë me  $H.D=24.0m$ . Mbistruktura e urës përbëhet nga 6 trarë b/a në formë T-je të cilët në drejtimin tërthor janë të lidhur me diafragma b/a. Gjerësia e urës është  $B=2x3.55m$  dhe në të dyja anët e saj ka trotuare me gjerësi  $b=2x1.05m$ . Në anë të trotuareve janë kufizuesit anësorë (Guardreila). Ura ka fuga në hyrje dhe në dalje. Elementët mbështetës anësor të urës përbëhen nga 2 ballna b/a, në hyrje dhe në dalje të urës. Mbështetja e mesit (Pila) përbëhet nga jastëku b/a, ku mbështeten trarët e mbistrukturës, 3 kolona b/a me seksion rrethor dhe themeli b/a i cili mbështetet mbi pilota rrethore. Në projektin e rikonstruksionit të urës së Kaludhit është realizuar mbrojtja e themeleve të pilës së mesit dhe sistemimi i shtratit të lumit (siç paraqitet në vizatime). Është bërë sistemimi i sipërfaqes përpara urës sipas drejtimit gjatësor të rrjedhjes së lumit. Punimet e parashikuara që do të kryhen janë: shtresa b/a për sistemimin e shtratit të



lumit (në hyrje), veshje me gabiona e skarpatave të pjesës së sistemuar, ndërtimi i Shuarsit, pilotat në dalje të sistemimit të urës, muret b/a në dalje të sistemimit, mbrojtja e mbështetjeve të urës.

**Ura e Leklit** ndodhet mbi lumin Drino, në rrugën nacionale Tepelenë - Gjirokastrë, afro 5km larg Tepelenës. Projekti i parë për ndërtimin e urës ka datën 14.10.1924 hartuar nga një studio projektuese franceze "Ateliers de Fives" Mbistruktura është kapriatë çeliku me shtresë druri. Ura ka dy hapësira drite (2x40) dhe gjatësi totale  $L=81m$ . Nënstruktura e saj është prej betoni. Themelet dhe krahët anësore janë të shkallëzuar e të thellë 2m. Lartësia e këmbës në mes të urës është 4m. Ndër punimet e parashikuara që të kryhen janë : heqja e shtresave asfaltike, pastrimi i piletave ekzistuese dhe zëvendësimi i tyre, vendosja e fugave të reja të zgjerimit, Vendosja e shtresave të reja asfaltike, Realizohet me dy pjerrësi,  $i=1.5\%$ . Pastrimi i strukturës metalike me rërë me presion, lyerja me bojë kundër ndryshkut dhe bojë dekorative. Riparimi i soletave në anën e poshtme të mbistrukturës, mbrojtja e shufrave të armaturës së çelikut me bojë përkatëse dhe tokretimi me çimento strukturore. Riparimi i elementeve të dëmtuar të strukturës prej çeliku. Pastrimi i çernierave dhe lubrifikimi i tyre. Përforcimi dhe mbrojtja e themelit të pilës dhe ballit nga Tepelena. Riparime të pjesshme të sipërfaqeve të betonit, të shpatullave e trotuarëve.

**Ura e Zëmlakut** ndodhet mbi lumin Devoll, në afërsi të fshatit Zëmlak, në rrugën nacionale Korçë - Pojan, afro 1.5km larg fshatit Zëmlak. Ura e Zëmlakut është një urë me 3 hapësira drite nga të cilat 2 hapësira janë më  $H.D=15.75m$  dhe një me  $H.D=18.20m$ . Mbistruktura e urës përbëhet nga trarë b/a në formë T-je. Gjerësia kaluese e urës është 6.0m dhe në të dyja anët e saj ka trotuare me gjerësi 1.0m. Në të dyja anët e urës ndodhen parmacë betoni anësor. Mbështetjet anësore përbëhen nga ballna masiv prej betoni. Mbështetjet e mesit përbëhen nga jastëku b/a dhe çdo mbështetje përbëhet nga një pilë prej betoni masiv. Pila e urës mbështetet në themelin masiv i cili mbështetet direkt në formacionin natyror të zonës. Pas studimit të varianteve të propozuara për rehabilitimin apo ndërhyrjet që do të bëhen në urën e Zëmlakut, këshilli teknik vendosi që zgjidhja përfundimtare të jetë ndërtimi i një ure të re. Ky variant konsiston në ndërtimin e një ure të re me 3 hapësira dritë me gjatësi 16.50 m dhe me mbistrukturë me dimensione në drejtimin tërthorë më të mëdha sesa ajo ekzistuesja. Mbështetjet anësore do të përbëhen nga ballna betonarme të mbështetur në pilota të cilat do të mbështeten në shtresën numër 6 siç jepet në vizatime dhe në studimin gjeologjik. Mbështetjet e mesit të urës do të përbëhen nga pila në formë drejtkëndore të cilat në kokë të tyre kanë jastëkun dhe poshtë kanë themelin në forme drejtkëndore, i cili mbështetet mbi pilota të cilat edhe këto mbështeten në shtresën numër 6 në përputhje me studimin dhe profilin gjeologjik. Për shumë informacione në lidhje me urën e re shiko kapitullin e llogaritjeve strukturore dhe vizatimet e projektit. Ura e zgjedhur do të ketë këto veçori: Urë me 3 hapësira dritë prej  $3 \times 16.50$  m, numri total i hapësirave dritë 3, mbistrukturë e përbërë nga trarë të zakonshëm në formë T-je, seksion tërthor me 7 trarë të baraslarguar midis tyre në drejtim tërthor 1.40m, nënstruktura me ballna dhe pila të derdhur në vend të mbështetur mbi pilota.

## II– OBJEKTIVI KRYESOR

Mbikëqyrësi i punimeve të zbatimit të punimeve për objektin ka për qëllim të kontrollojë dhe të ndjekë mbarëvajtjen e gjithë procesit të zbatimit të punimeve në përputhje me



projektin, kushtet teknike të zbatimit, specififikimet teknike si dhe destinacionin e objektit duke patur parasysh afatin kohor të përcaktuar për kryerjen e punimeve të këtij objekti dhe anën ekonomike të këtij objekti (vlefata e kontratës).

### III - DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE TË DREJTAT E MBIKËQYRËSIT

Në realizimin e objektivave për zbatimin e punimeve të objektit “**Rikonstruksioni i Urave të Kaludhit, Dragotit dhe Leklit; Ndërtimi i Urës së Zëmlakut**”, mbikëqyrësi menjëherë mbas lidhjes së kontratës duhet:

- Të mbikëqyrë Kontratën e zbatimit të punimeve në emër të Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe të kryejë të gjitha detyrimet e besuara atij sipas Kontratës së nënshkruar dhe sipas Ligjit Nr. 8402 datë 10.09.1998, te ndryshuar, UKM Nr.3 dt.15-02 2001, UKM Nr.1 dt. 22.02.2005, UKM Nr 2 dt.13.5.2005 dhe të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore të dala për këtë qëllim.
- Të njihet në detaj me projekt zbatimin dhe specififikimet teknike të objektit, të hartojë programin e kontrollit për zbatimin e projektit dhe cilësisë së punimeve në bazë të standarteve të përcaktuara me ligj.
- Të paraqesë pranë ARrSH-së stafin e tij mbikëqyrës në përbërje të të cilit duhet të ketë:

**Drejtuesin e projektit** i cili duhet të jetë inxhinier ndërtimi, me eksperiencë pune në mbikëqyrje i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, miratimin e volumeve të punimeve, çertifikatën e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimeve të volumeve, korespondencën me ARrSh.

- Drejtuesi i punimeve do të jetë rezident në objekt gjatë gjithë kohës së kryerjes së punimeve të kontraktuara dhe stafi tjetër mbështetës do të jetë rezident apo me kohë të pjesëshme sipas kushteve të miratuara ë kontratës.
- Mbikëqyrësi i punimeve dhe stafi i tij në zbatim të kontratës me Autoritetin Rrugor, përcakton detyrimet e ndërsjellta, kushtet e punës, shpërblimin dhe probleme të tjera etj.
- Mbikëqyrësi vihet në dijeni nga Autoritetit Rrugor për nënkontraktorët e mundshëm që zgjedh sipërmarrësi në përputhje me kontratën e nënshkruar .
- Mbikëqyrësi i punimeve merr në dorëzim kontratën në mes autoritetit kontraktor dhe zbatuesit të punimeve per ndjekje sipas ligjit dhe ketyre Termave të Referencës.
- Mbikëqyrësi në fillim të punimeve në objekt merr kontakt me organet e pushtetit lokal në juridiksionin e të cilit ndodhet zona ku kryhen punimet për përmirësimin e këtyre pikave, Drejtoritë e Rajoneve sipas pikave përkatëse, apo aktore në këtë objekt dhe informon për detajet e projektit duke përfshirë shpronësimet në pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, spostimet e ndryshme që mund të bëhen në objekt, dhe çdo detaj tjetër projekti që prek, ndikon apo implikon këto institucione apo organizmat tjera të interesuara, njofton për personat kryesorë, përgjegjës për ndërtimin e këtij objekti, në përputhje me nenin 9, të ligjit Nr 8402 ,dt 10.09.1998 dhe akteve nënligjore.



### ***Mbikëqyrësi ka për detyrë:***

- Të bëj verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës, të licencave, të autorizimeve dhe të lejeve, të cilat sipas dispozitave në fuqi duhet të merren para fillimit të punimeve.
- Të bëj verifikimin e sheshit të ndërtimit nëse është i lirë dhe i gatshëm për të filluar punimet.
- Të njihet mirë me kontratën e sipërmarrësit dhe të gjitha akteve administrative që lidhen me të si dhe të njohë të gjitha ndryshimet e mundshme të kësaj kontrate me kalimin e kohës.
- Të verifikojë stafin e sipërmarrësit në objekt, numrin e punonjësve dhe specialistëve sipas kontratës dhe makineritë apo paisjet që kontraktori do të përdorë për përmbushjen e detyrimeve të kontratës.
- Të evidentojë që në fillim sinjalistikën ekzistuese, me qëllim shmangien e mbivendosjes së projektit të ri me detyrat kontraktuale të mirëmbajtjes rutinë me performancë, apo implementimit të projekteve të tjera lidhur me përmirësimin e sigurisë rrugore.
- Të ndihmojë në bashkëpunimin me strukturat e Policisë Rrugore lidhur me zbatimin e grafikut të punimeve në momentet e bllokimit/ngushtimit të rrugëve nga punimet e vijëzimit apo montimit të guardreleve.
- Të kontrollojë e të miratojë sinjalistikën provizore në rastet e kryerjes së punimeve të cilat lidhen me bllokimin apo ngushtimin e rrugëve.
- Të verifikojë rregjistrin e sigurimit teknik të punëtorëve për llojin e punimeve që do të kryhen në rrugë.

Mbikëqyrësi menjëherë mbas lidhjes së kontratës duhet :

- Të marrë masat e duhura për sigurinë e objektit duke kontrolluar vendosjen në objekt të tabelave përkatëse sinjalizuese, treguese të sigurisë, shiritave, fenerëve etj.
- Mbas verifikimit të dokumentacionit duhet të dorëzojë pranë ARrSh-së të gjithë dokumentacionin si dhe shkresën për fillimin e punimeve ku përfshihen:
  - i) Stafin e Sipërmarrësit
  - ii) Makineritë që do përdoren për ndërtimin e objektit.
- Para fillimit të punimeve verifikon të gjitha pajisjet dhe makineritë e sipërmarrësit, për të parë nëse ato i përgjigjen kushteve të kontratës së nënshkruar.
- Të kontrollojë ecurinë e punimeve duke u bazuar në projekt zbatimin, standartet e miratuara dhe specifikimet teknike si dhe të propozojë modifikimet, plotësimet dhe mospërputhjet, nëse ka, dhe t'i propozojë A.Rr.Sh zgjidhjet konkrete.
- Të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme e të kualifikuar gjatë të gjitha proceseve të punimeve dokumentacionet që duhen të mbahen gjatë zbatimit të punimeve, miratimin e analizave të veçanta, duke dhënë udhëzime, porosi e urdhëra për zbatimin me përpikmëri e në kohë të projektit, të kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit, të dispozitave përkatëse të kontratave.
- Të kërkojë zbatimin në mënyrë korrekte të plan – organizimit të punimeve .
- Të kërkojë zbatimin në mënyrë korrekte të grafikut të detajuar të punimeve
- Të kërkojë dhe të monitorojë zbatimin e lejeve të ndryshme (autorizimin, pëlqimin mjedisor etj), të miratuara nga organet kompetente .
- Të respektojë zbatimin e detyrave të lëna në dokumentacionin përkatës kur objekti ndërtohet në zonat turistike, arkeologjike apo të trashëgimisë kulturore .
- Të kontrollojë çdo material që vendoset në vepër, mënyrën e vendosjes së tij dhe cilësinë e tij



- Të monitorojë dhe të kontrollojë vendosjen e sinjalistikës së përkohëshme në objekt gjatë zbatimit të punimeve duke u siguruar që këto të bëhen sipas specifikimeve teknike dhe standarteve të miratuara.
- Për çdo punim të maskuar të bëjë fotografimin ose regjistrimin e tij dhe të mbajë proces verbal të firmosur prej tij dhe sipërmarrësit. (formati tip sipas udhëzimit Nr 1 dt 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin Nr 3 datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar apo akteve tjera nënligjore që kanë hyrë apo hyjnë në fuqi gjatë zbatimit të punimeve).
- Në çdo fund ditë pune të kontrollojë ditarin e punimeve dhe ta firmos atë. (formati tip sipas udhëzimit Nr 1, dt 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin Nr 3 dt 15.02.2001 të këshillit të ministrave për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar) dhe akteve tjera nënligjore)
- Të kontrollojë situacionet e paraqitura nga sipërmarrësi në fazat e ndryshme të punimeve dhe miratojë ato. (formati tip sipas udhëzimit Nr 1, dt 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin Nr 3 dt 15.02.2001 të këshillit të ministrave për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar)
- Të kontrollojë librin e masave ku pasqyrohen vëllimet metrike gradualisht me zhvillimet e tyre (formati tip sipas udhëzimit Nr 1, dt 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin Nr 3 dt 15.02.2001 të këshillit të ministrave për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar) i cili vërteton volumin e punimeve dhe t’u miratojë atë.
- Të kontrollojë çertifikatat e cilësisë së materialeve dhe të jap miratimin për vendosjen në objekt të tyre .
- Gjatë zbatimit të projektit, i jep instruksione me shkrim sipërmarrësit, sa herë që e shih të nevojshme, dhe sipërmarrësi është i detyruar t’i zbatojë ato. Ky i fundit ka të drejtë të bëjë me shkrim vërejtjet e tij lidhur me instruksionet dhe urdhërat e marrë.
- Për çdo rast, që gjatë zbatimit të punimeve lind nevoja e ndryshimeve në projektin dhe preventivin e parashikuar, Mbikëqyrësi i Punimeve, mbasi të bindet vetë dhe të japë miratimin e tij për zgjidhjen teknike, duhet t’i paraqesë Autoritetit Rrugor Shqiptar një relacion të plotë teknik (shoqëruar me skicat përkatëse) ku argumentohet ndryshimi.
- Ndryshimi në objekt (zbatimi i punimeve) do të bëhet vetëm pas miratimit nga Autoritetit Rrugor Shqiptar.
- Të nënshkruajë aktin përfundimtar të kontrollit të punimeve për faza të ndryshme.
- Në çdo fund muaji mbikëqyrësi ka për detyrë të paraqesë pranë A.Rr.Sh -së raport mujor të hollësishëm të punimeve. Në këtë raport duhet të jepet një tablo e qartë e avancimit të punimeve dhe të pagesave të kryera. Realizimi i punimeve në vleftë, afati kohor, realizimi i financimit dhe të gjitha problematikat e dala gjatë zbatimit dhe zgjidhjet e dhëna nga mbikëqyrësi dhe kontraktori.
- Mbikëqyrësi gjatë të gjithë fazës së mbikëqyrjes së zbatimit të punimeve duhet të plotësojë kërkesat si më poshtë;
- Mbikëqyrësi i punimeve duhet të ketë licensë për mbikëqyrje dhe kolaudim në kategoritë:

NP-1 Punime gërmimi në tokë;

NP-4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale;

NP-5 Punime nëntokësore, ura e vepra arti;

NP-9 Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime;

NS-6 Sinjalistika rrugore jo ndriçuese;

NS-7 Barrierra dhe mbrojtje rrugore;

NS-8 a. Ndërtime parafabrikat beton arme.



NS-8 b. Struktura metalike;  
NS- 9 Punime strukturore special;  
NS-10 Shtresa dhe mbistruktura speciale.

- Drejtuesi i projektit duhet të ketë licensë projektimi në kategoritë:  
7. PROJEKTIM URA DHE VEPRA ARTI  
a- Ura dhe vepra arti të vogla deri më 10 m.  
b- Ura dhe vepra arti mbi 10 m.  
c- Ura/viadukte me hapësira të mëdha drite, ura të varura, ura me sisteme të pacaktuara statikisht dhe sisteme të tjera speciale.  
d- Ura metalike.

***Raporti Mujor do të ketë këtë përmbajtje:***

- Hyrje
- Informacion i përgjithshëm
  - Qëllimi i punimeve
  - Objektivi
  - Mbikëqyrja e punimeve ndërtimore
- Personeli i siguruar nga Mbikëqyrësi
  - Stafi i nevojshëm në përputhje me kontratën e zbatimit të punimeve .
  - Stafi aktual
  - Kohëqëndrimi në objekt për secilin.
- Raportimi
- Kohëzgjatja e shërbimit të Mbikëqyrjes
- Përshkrimi i Projektit
  - Shtresat Rrugore
  - Veprat e Artit nëse ka, etj.
- Organizimi i Sipërmarrësit
  - Sipërmarrësi
  - Stafi prezent
  - Mjete dhe makineri
  - Kohëqëndrimi në objekt
- Progresi Mujor
- Përshkrim të Punimeve që janë kryer gjatë muajit (sipas zërave dhe piketave);
- Fotografi të proceseve të punimeve të kryera;
- Fotografi të punimeve të maskuara për çdo punim të padukshëm;
- Grafiku i ecurisë së punimeve
  - a -Të aprovuara
  - b -Të kryera
- Volumet Progresive të Punimeve Mujore
  - a - Punimet e aprovuara
  - b - Çertifikatat e cilësisë dhe Provat Laboratorike
  - c - Libreza e Masave
  - d - Punimet e kryera por të pa aprovuara
  - e - Situacionet mujore
  - f- Matjet topografike



- Korrespondenca
  - a-Proces-Verbale
  - b-Urdhëra, Udhëzime, Njoftime
  - c-Ndryshime në Projekt dhe Preventiv nëse ka (të aprovuara nga ARrSh-ja)
- Moti (kalendarik)
- Problemet që kanë dalë
  - a-Teknike
  - b-Sociale
- Konkluzione

**Shënim :** Raporti Mujor dhe dokumentet duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, në pesë kopje dhe tre kopje të dorëzohen në ARrSh pranë Drejtorisë Zhvillimit Projekteve të Brendshme, të Huaja dhe Shpronësimeve

Raporti Mujor do t'i dorëzohet ARrSh-së brenda datës së caktuar në kontratë.

Mbikëqyrësi do të mbajë kontakte të vazhdueshme me ARrSh (Drejtorinë Zhvillimit Projekteve të Brendshme dhe Drejtorinë Teknike) dhe do t'i përgjigjet të gjitha kërkesave të saj.

### ***Mbikëqyrësi mban përgjegjësi të plotë;***

Në fillim të punimeve mbikëqyrësi mban dhe ka përgjegjësi për dokumentacionin e mëposhtëm:

- Projekt zbatimin e firmosur nga projektuesi dhe investitori së bashku me specifikimet teknike
- Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinierik të bazamentit ku do të kryhen punimet
- Realizimin e punimeve të objektit sipas projektit kushteve teknike të zbatimit në fuqi dhe specifikimeve teknike
- Saktësinë e vërtetësinë e dokumenteve volumet dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.
- Për realizimin pike për pikë të kontratës së nënshkruar midis Sipërmarrësit dhe A.Rr.Sh-së e të gjitha fazave të zbatimit të punimeve, respektimit të afatit të dorëzimit si dhe të kostos së objektit.
- Asnjë punim nuk do të mbulohet, maskohet apo betonohet pa miratimin e mbikëqyrësit.
- Ruajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe korespondencën me Drejtorinë e Zhvillimit të Projekteve të Huaja, të Brendshme dhe Shpronësimeve urdhërat e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të kontratës, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që i kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike të kërkuara ose të paraqitura gjatë zbatimit si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjithë fazave të zbatimit të punimeve.

Për dorëzimin e gjithë dokumentacionit që disponon në rast se gjatë zbatimit të kontratës kemi ndërrim të mbikëqyrësit, i gjithë dokumentacioni dorëzohet me proces verbal ku shënohen dhe shkaqet e këtij ndërrimi.





### ***Mbikëqyrësi ka të drejtë :***

- ◆ Të kërkojë largimin nga puna të drejtuesit të kantierit ose të punëtorëve të veçantë për mosbindje, paaftësi ose pakujdesi të rëndë.
- ◆ Të mos pranojë drejtues teknik, manovrator, punëtor n.q.s këta nuk plotësojnë kushtet për të kryer detyrën e caktuar.
- ◆ Të pezullojë punimet kur sheh se në objekt nuk janë marrë masat e duhura për të siguruar punimet dhe trafikun.
- ◆ Të mos lejojë vendosjen në vepër të materialeve që nuk plotësojnë kushtet e cilësisë dhe t'i zëvendësojë ato me materiale të tjera nga sipërmarrësi me shpenzimet e tij.
- ◆ Të kërkojë certifikatat e cilësisë së pajisjeve që kryejnë testet e materialeve.
- ◆ Të kërkojë dhe të asistojë në kryerjen e provave të materialeve, për të verifikuar cilësinë e tyre. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarrësit.
- ◆ Të kërkojë për të gjitha makineritë që punojnë në vepër dokumentacionet teknike për të siguruar një ecuri punimesh të sigurtë dhe cilësore.
- ◆ Të mos lejojë përdorimin e makinerive dhe pajisjeve të ndryshme n.q.s ato janë jashtë kushteve teknike.
- ◆ Në rast se materialet dhe pajisjet e përdorura nuk miratohen nga mbikëqyrësi, këto duhet të dokumentohen me proces verbalet e analizave të provave sëbashku me aktin teknik, ku të argumentohen shmangjet e palejuara, referuar standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike të projekt zbatimit.
- ◆ Kur Mbikëqyrësi i punimeve mendon se ka dëmtime në konstruksion kërkon të bëhen verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë mbikëqyrësit, shpenzimet janë në ngarkim të sipërmarrësit. Në rast të kundërt, sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve në rrugë kontraktuale.
- ◆ Mbikëqyrësi i Punimeve urdhëron Sipërmarrësin të prishë dhe të ribëjë me shpenzimet e tij, punime të bëra jo me cilësinë e parashikuar në projekt dhe specifikimet teknike.
- ◆ Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të pezullojë përkohësisht punimet, për ekzekutim teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, për çdo rast me miratimin e ARrSh-së për aq kohë sa ai e konsideron të arsyeshme. Në këtë rast sipas shkakut, mbikëqyrësi së bashku me ARrSh-në dhe sipërmarrësin përcaktojnë zgjatjen ose jo të afatit dhe ndryshimin e shpenzimeve.
- ◆ Të kontrollojë dhe autorizojë përdorimin e fondit rezervë të preventivuar dhe i raporton periodikisht ARrSh-së për gjendjen e tij.
- ◆ Për çdo ndryshim të mundshëm mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve në fjalë.

### ***Në përfundim të punimeve mbikëqyrësi:***

- Merr me shkrim njoftimin për përfundimin e punimeve dhe vërteton në proces verbal datën e përfundimit të tyre sipas projektit, të ndryshimeve të urdhëruara e të kushteve të kontratës dhe brenda 30 ditëve merr prej sipërmarrësit dokumentacionin përkatës .
- Duke u mbështetur në Ligjin 8402 dt 10.09.1998 UKM Nr 2 datë 13.5.2005 dhe UKM Nr 3 datë 15.02.2001 dorëzon pranë ARrSh –së, të gjithë dokumentacionin përkatës për të cilin mban përgjegjësi të plotë në plotësimin, saktësinë, vërtetësinë e tij.



## **Ky dokumentacion duhet të përmbajë :**

- Proces verbal i dorëzimit të sheshit të ndërtimit.
- Proces verbal për fillimin e punimeve.
- Kontraten e sipërmarrësit
- Kontratën e mbikëqyrjes
- Projekt organizimi i punimeve.
- Projektin
- Projektin e ndryshuar (nëse ka) shoqëruar me korespondencën skicat përkatëse dhe miratimet e nevojshme.
- Preventivin fitues
- Preventivin e ndryshuar (nëse ka zërat të rinj të punimeve negocimin e tyre).
- Grafiku i punimeve
- Specifikimet teknike
- Axbornimi para fillimit të punimeve dhe piketimi.
- Dokumentacioni fotografik apo video regjistruesi për punimet e padukshme.
- Proces-verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe mbikëqyrësi të shoqëruar me fotografi.
- Ditari i objektit ku të pasqyrohen dhe ndryshimet e urdhëruara nga mbikëqyrësi.
- Libreza e masave.
- Shkresën e mbikëqyrësit për investitorin ku raporton përdorimin e fondit rezervë i shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
- Proces verbal i përdorimit të fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarrësi (Drejtuesi teknik) dhe Mbikëqyrësi
- Preventivi i fondit rezervë të firmosur nga sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe mbikëqyrësi
- Situacion i fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe mbikëqyrësi
- Certifikatat e cilësisë së materialeve.
- Miratim i materialeve të përdorura nga mbikëqyrësi.
- Situacionet pjesore dhe atë përfundimtar.
- Regjistri i kontabilitetit.
- Deklarata teknike e sipërmarrësit e firmosur nga sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik.
- Njoftimi i sipërmarrësit për përfundimin e punimeve.
- Proces verbal i përfundimit të punimeve të firmosur nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi së bashku me matjet faktike të objektit të ndërtuar.
- Relacionin përfundimtar i mbikëqyrësit

I gjithë dokumentacioni duhet të ketë miratimin e tij. Ky dokumentacion është në 5 (pesë) kopje. Një kopje e të gjithë dokumentacionit dorëzohet pranë grupit të kolaudimit që ngrihet me urdhër nga ARrSh -ja brenda 30 ditëve nga përfundimi i objektit. Të gjithë dokumentat që dorëzohen Grupit të Kolaudimit pranë ARrSh -së duhet të jenë origjinale.

Mbikëqyrësi i Punimeve merr pjesë në kolaudimin e objektit dhe i përgjigjet Grupit të Kolaudimit për të gjithë dokumentacionin e nevojshëm gjatë kolaudimit të objektit dhe nënshkruan aktin përkatës. Pas përfundimit të kolaudimit, mbikëqyrësi i punimeve, mbështetur



në kontratën dhe në dokumentacionin tjetër, përcakton vlerën përfundimtare të objektit e cila i bëhet e ditur sipërmarrësit dhe i jepet për të likujduar ARrSh-së.

#### **IV - KOHËZGJATJA E SHËRBIMIT TË MBIKËQYRJES**

Do të jetë për gjithë periudhën e zbatimit të punimeve.

#### **V – TË DREJTAT E A.RR.SH-SË.**

ARrSh-ja ka të drejtë të kërkojë largimin e mbikëqyrësit kur vërteton mangësi serioze në veprimtarinë e tij si:

- Mangësi në plotësimin e detyrave të përcaktuara;
- Ndërprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre;
- Mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet;
- Tolerim i materialeve me vlera mbi ato të preventivuara;
- Tolerim të materialeve jashtë cilësisë së kërkuar;
- Tolerim të punimeve jo me cilësinë e kërkuar;
- Tolerim të pajisjeve jashtë kushteve teknike;

Kur vërehen shkelje të rënda të dispozitave ligjore, ARrSh-ja ka të drejtë të urdhërojë mbikëqyrësin e punimeve për ndërprerjen e punës deri në marrjen e masave përkatëse për normalizimin e gjendjes. Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund të përbëjnë kundërvajtje administrative, vendosen sanksione në bazë të neneve 15 dhe 16 të kreut III të ligjit Nr 8402 dt 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"

#### **VI - MËNYRA E DHËNIES SË OFERTËS.**

Oferta jepet në vleftë totale e zbërthyer në shpenzime për muaj - person (sipas preventivit bashkangjitur) dhe shpenzime të tjera të nevojshme për t'u kryer.

#### **VII - MËNYRA E PAGESËS**

Pagesa do të bëhet mujore në bazë të % së realizimit të punimeve të zbatimit e zbërthyer sipas shpenzimeve muaj- person.

#### **VIII - STAFI**

1. **Drejtor Projekti – Ing Ndertimi**, - Do të llogaritet për të gjithë kohën e plotë të kontratës.

Me eksperience pune mbi 10 (dhjetë) vjet në mbikëqyrjen e ndërtimit/rikonstruksionit të rrugëve. Preferohet të ketë eksperiencë të mëparëshme në punimet që lidhen me urat dhe veprat e artit, si projekte dhe mbikëqyrje.

2. **Inxhinier hidroteknik** me eksperiencë pune mbi 5 vjet, me kohë të plotë.
3. **Inxhinier materiali** me eksperiencë pune mbi 5 vjet, me kohë të plotë.
4. **Ing. Mekanik** me eksperiencë pune mbi 5 vjet, me kohë të pjesshme.
5. **Inxhinier gjeodet**



**PREVENTIV  
MBIKËQYRJE PUNIMESH**

**Objekti “ Rikonstruksioni i Urave të Kaludhit, Dragotit dhe Leklit; Ndërtimi i Urës së Zëmplakut”**

Vlera e kontratës \_\_\_\_\_ lekë (me TVSH)

| Nr                | Emërtimi              | Njësia      | SHPENZIMET |       |        |
|-------------------|-----------------------|-------------|------------|-------|--------|
|                   |                       |             | Sasia      | Çmimi | Vlefta |
| I                 | <b>Stafi</b>          |             |            |       |        |
| 1                 | Drejtor projekti      | Staf - Muaj | (100%)     |       |        |
| 2                 | Inxhinier hidroteknik | Staf - Muaj | (100%)     |       |        |
| 3                 | Inxhinier mekanik     | Staf – Muaj | (20%)      |       |        |
| 4                 | Inxhinier gjeodet     | Staf – Muaj | (100%)     |       |        |
| 5                 | Inxhinier materiali   | Staf – Muaj | (100%)     |       |        |
|                   | <b>Shuma 1</b>        |             |            |       |        |
| II                | <b>Shpenzime</b>      |             |            |       |        |
| 1                 | Shpenzime të ndryshme | Lump sum    |            |       |        |
| 2                 | Paisje, materiale etj | Lump sum    |            |       |        |
|                   | <b>Shuma 2</b>        |             |            |       |        |
| <b>Shuma I+II</b> |                       |             |            |       |        |
| <b>TVSH 20 %</b>  |                       |             |            |       |        |
| <b>Totali</b>     |                       |             |            |       |        |

**MBIKËQYRËSI I PUNIMEVE**

“ \_\_\_\_\_ ”

